

DORACAK
PËR PUNË
NË ORË

i dedikuar për nxënësit
e arsimit të
mesëm në temën

LUFTË KUNDËR KORRUPSIONIT

A stylized illustration of a man in a dark blue suit and hat, standing on a light blue background. A large red diagonal stripe runs across the image. The man is holding a dark blue briefcase filled with green banknotes. The title 'LUFTË KUNDËR KORRUPSIONIT' is written in large white letters across the center.

mars 2020

Titull

Doracak për punë në orë i dedikuar për nxënësit e arsimit të mesëm në temën "Luftë kundër korrupsionit"

Botues

Instituti për demokraci "Societas Civilis! - Shkup
contact@idscs.org.mk
www.idscs.org.mk
mars, 2020

Autorë

m-r Liljana Pecova Ilieska
d-r Kire Babanoski
Ana Janevska Deleva

Dizajni

Matea Londza Shumkovska

Përkthim

Mustafa Peza

Doracaku është i përpiluar në kuadër të projektit "Edukimi anti-korrupsues për nxënës në shkollat e mesme" të financuar me ndihmë të Ambasada e Mbretërisë së Hollandës në Shkup, i implementuar nga Instituti për demokraci "Societas Civilis", Shkup në bashkëpunim me Komisionin Shtetëror për pengim të korrupsionit, në periudhën nga 1 janari i vitit 2019 – 31 dhjetor të vitit 2020.

Në kuadër të projektit në grupin punues për implementimin e temave të antikorrupsionit në arsimin e mesëm merrnin pjesë edhe përfaqësues të Ministrisë për arsim dhe shkencë, njëjloj si byroja për zhvillim të arsimit.

PËRMBAJTJE

HYRJE	5
1. ÇFARË ËSHTË KORRUPSIONI	6
1.1. TIPE DHE LLOJE TË KORRUPSIONIT	10
1.2. EFEKTE/PASOJA NGA KORRUPSIONI	13
2. DALLIMI I KORRUPSIONIT NË SFERA TË NDRYSHME TË JETËS SHOQËRO	16
3. BALLAFAQIMI DHE PENGIMI I KORRUPSIONIT	24
3.1. MJETE PËR LUFTË KUNDËR KORRUPSIONIT	30
LITERATURË E PËRDORUR	37

HYRJE

Ky Doracak është i dedikuar për nxënësit nga arsimi i mesëm të cilët e mësojnë temën “Luftë kundër korrupsionit”.

Gjatë vazhdës së mësimet **do të do të mësosh** shumë nocione dhe informacione, e në të njëjtën kohë do të njihesh me definicionet për: korrupsion, anti-korrupsion, integritet, etikë, presion social, interes privat, interes publik, përgjegjësi publike e kështu me radhë.

Në të njëjtën kohë, me këtë Doracak **ti dhe nxënësit tuaj** do të motivoheni **të hulumtoni dhe të analizoni**, për ta kuptuar **ndikesën negative të korrupsionit** për shoqërinë, zhvillimin shoqëror, grupor dhe njerëzor/personal.

Dallimi dhe paraqitja e korrupsionit janë mjete të rëndësishme për pengim të korrupsionit.



AKTIVITET

Përmes shembujve dhe aktiviteteve dhe temat për diskutim, nxënësit do të nxiten të bëjnë hulumtime, të demonstrojnë **vetëdije për përgjegjësinë civile**.



Aktivitetet hulumtuese do të ndihmojnë edhe në detyrat e përditshme shkollore dhe do të motivojnë të mendojnë dhe të parashirojnë pyetje.



TEMË PËR DILEMË

Shembujt e dhënë si “temë për dilemë” janë të vendosura për dallimin e situatave në të cilat manifestohen forma të korrupsionit, mos ekzistimit të etikës dhe të presionit social dhe të reagohet me dënim ndaj tyre.

1. ÇFARË ËSHTË KORRUPSIONI?



Përkufizimi i korrupsionit

Korrupsioni paraqet dukuri negative në shoqërinë. Nocioni "korrupsion" buron nga termi latin *corruptio* i cili përkthehet si blerje/mitdhënie, prishje/korrupsion, kalbje dhe shpërbërje si proces.

KORRUPSIONI ËSHTË SHFRYTËZIM TË POZITËS ZYRTARE PËR QËLLIME PRIVATE.

Kjo do të thotë se korrupsioni ekziston kur persona zyrtarë kryejnë punë të caktuara të cilat janë gjithsesi të obliguar ti punojnë në pajtim me ligjin, por kërkojnë për atë ndonjë farë kundërshtësie ose para.

Individi i cili sillet në mënyrë korruptive, përmes keqpërdorimit të pozitës së vet, merr përfitime materiale ose jomateriale ose volitshmëri të caktuara, që mund të jenë të dedikuara për të ose për ndonjë tjetër person. Në këtë mënyrë, persona të caktuar marrin përfitim në mënyrë jolegjale, ndërsa të tjerëve u është vështirësuar realizimi i ndonjë të drejte e cila në rast tjetër nuk ju takon.

Korrupsioni është sjellje e ndaluar e cila e rrezikon demokracinë dhe sundimin e të drejtës. Ajo do të thotë se në vend që të sundojë drejtësia dhe vlerat e saj, në shtetin në të cilin ka korrupsion sundojnë individë të cilët janë të udhëhequr nga qëllime personale përfituese. Korrupsioni e pamundëson realizimin e të drejtës për gjasa të njëjta për sukses në jetën, si dhe garë të njëjtë të kompanive në tregun e kapitalit dhe të shërbimeve.

Aktivitetet dhe sjelljet korruptive paraqiten në të gjitha shtresat dhe fushat e jetës shoqërore. Për nga ana gjeografike, korrupsioni nuk njeh kufij. Korrupsioni është dukuri që në mënyrë të njëjtë i sulmon si shtetet e zhvilluara, ashtu edhe ato të pazhvilluara. Asnjë vend, pa marrë parasysh atë se sa është demokratik, nuk është imun ndaj korrupsionit. Kjo "sëmundje shoqërore" në mënyrë të njëjtë i sulmon: funksionarët qeveritar, politikanët, njerëzit afarist, drejtorët, profesorët, mjekët, gjykatësit, avokatët dhe të gjithë ata të cilët në mënyrë të caktuar kryejnë ose janë në funksion të kryerjes së ndonjë veprimtarie publike.



MBAJ NË MEND:

Nën korrupsion nënkuptohet keqpërdorimi i funksionit, detyra ose pozita zyrtare për shkak të realizimit të përfitimit personal, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose përmes ndërmjetësit, për vete ose për tjetërkënd.

Kushtet kryesore:

“Detyrë zyrtare” do të thotë shumë të obligimeve të cilat një person është i obliguar ti ndërmarrë, e të cilat burojnë nga kryerja e një funksioni ose profesioni të caktuar, përkatësisht nga pozita zyrtare të atij personi.

Shembull:

Polici në sajë të detyrës zyrtare patjetër duhet të ndërmarrë ndonjë veprim **nëse konstaton** se ndonjë nga pjesëmarrësit në komunikacionin e rrezikon jetën e tjerëve me vozitje të shpejtë ose mosrespektim të shenjave të komunikacionit ose rregullat në rrugën. Mosndëshkimi do të kishte thënë edhe mosveprim në sajë të detyrës zyrtare. Sjellja korruptive do të do të kishte pasur kur për të mos e ndëshkuar kryerësin do të kërkojë për vete ose për të tjerë mjete të caktuara materiale ose shërbim.

Nën nocionin **“dobi”** nënkuptohet realizim të çfarë do qoftë përfitimi material ose jo-material, dobi personale, volitshmëri ose avantazh për vete ose për person tjetër.

Nën nocionin **“rrezik nga korrupsioni”** nënkuptohet çfarë do qoftë lloji të dobësisë të jashtme ose të brendshme ose procedurë e cila paraqet mundësi për paraqitje të korrupsionit.

Nën **„konflikt të interesave”** nënkuptohet gjendja në të cilën personi zyrtar ka interes privat që ndikon ose mund të ndikojë mbi realizimin e të paanshëm të detyrave të tija zyrtare.

Shembull:

Në një shkollë të mesme është shpallur konkurs për punësim të psikologut. Në konkursin paraqiten 50 persona, midis të cilëve edhe e bija e drejtorit. Komisioni i përbërë nga disa anëtarë, midis të cilëve edhe drejtori, vendos për zgjedhjen e kandidatit më të mirë. Vajza e drejtorit nuk përmbush vetëm një kusht në pajtim me konkursin, ka vetëm 2 vite në vend të më së paku 5 vite përvojë pune. Prapëseprapë Komisioni vendos që ajo të përzgjidhet dhe të punësohet.

Detyrë:

1. Thekso vetëm disa shembuj tuaj për nocionet e lartpërmendura.
2. Thekso se çfarë nënkupton me "korrupsion".
3. Përse është me rëndësi që të zvogëlohet korrupsionit në shoqëritë demokratike?
4. Jep një shembull tjetër për "konflikt të interesit".



AKTIVITET

Arsimtari do të të japë shembull për diskutim ose detyrë me shkrim.
Përgjigju në pyetjet:

1. Si e nënkupton ti nocionin "korrupsion" në shembullin e dhënë?
2. Cila sjellje në shembullin është korruptive dhe përse?
3. Cili person është korruptiv dhe cili është qëllimi?
4. A ka dëm?


1.1 TIPA DHE LLOJE TË KORRUPSIONIT

Të përsërisim: Nën korrupsion nënkuptohen aktivitete joligjore me të cilat dikush merr ndonjë përfitim, jashtë nga rregullat, pa dallim nëse atë përfitim e marrin me veprim aktiv të institucioneve ose me mos-veprim.

Në përgjithësi, korrupsioni mund të ndahet në: korrupsion pasiv dhe aktiv.

Nëse ndonjë person zyrtar kërkon, merr ose pranon ndonjë përfitim, shërbim ose mjete, atëherë bëhet fjalë për korrupsion pasiv, e ndërsa premtohet ose jepet diçka e tillë, atëherë bëhet fjalë për korrupsion aktiv.

Varësisht nga ajo se cilin funksion e kanë në vendosjes hierarkike të administratës shtetërore dhe publike ata që janë kryerës të aktiviteteve korruptive, si dhe nga madhësia e dëmit dhe të rrezikut shoqëror që mund të shkaktohet, dallon tipat dhe llojet vijuese të korrupsionit:



Korrupsioni i lartë është ai në të cilin janë të përfshirë funksionarët dhe/ose politikanë të ranguar, përkatësisht të pozicionuar më lartë – dhe më shpesh përfshin keqpërdorim të shumës më të madhe të parave dhe/ose të ndikimit. Pozicioni i tyre është i tillë që mund të sjellin vendime për të gjithë qytetarët, e kështu puna e tyre e korruptuar sjell dëm më të madh. Ata mund të shkruajnë ligje të këtilla të cilat do të jenë në dobi të bashkëpunëtorëve dhe/ose kushërinjve, miqve të tyre, e jo në dobi të qytetarëve. Ata mund të keqpërdorin shuma milionëshe nga tatimet e qytetarëve.

Shembull:

për korrupsion të lartë është kur Këshilli Komunal mundëson që të sillet vendim me të cilin lejohet të ndërtohet ndërtesë në lokacion atraktiv, duke mos u mbajtur me atë rast llogari për efektin e ndotjes dhe për ambientin jetësor. Anëtarët e Këshillit në atë mënyrë punojnë edhe në dobi të ndërtimtarëve, duke mos mbajtur llogari për shëndetin e njerëzve.

Në menyrë shtesë, e tërë ajo transmetohet poshtë sipas hierarkisë ndaj nëpunësve të cilët duhet ta kryejnë vendimin e miratuar dhe në atë mënyrë paraqet bazë për përhapje të korrupsionit të mesëm dhe të ulët.

Korrupsioni i mesëm është i vendosur në hierarkinë shtetërore, gjë e cila te të gjithë nëpunësit që janë ekzekutues, përkatësisht të cilët duhet të zbatojnë vendime të miratuara në nivel më të lartë punues, pa dallim nëse bëhet fjalë për organizatë politike ose administrative.

Korrupsioni i ulët zhvillohet midis shtresave më të ulta të administratës, për shembull – nëpunësit publik, policët, punëtorët shëndetësor, arsimor, gjyqësor, doganor, komunal, të sporteleve e të tjerë. Si shembull për sjellje korruptive në arsimin e lartë është kur profesori në fakultet është autor i librit dhe kërkon nga studentët e tij që ta blejnë librin si kusht për ta dhënë provimin.



AKTIVITET

Arsimtari do të të japë shembull për diskutim.

1. Përcakto se çfarë lloji të korrupsionit bëhet fjalë.
2. A bëhet sjellja korruptive me kërkesë, dhënie, marrje, pranim ose premtim?
3. Kush e kryen veprimin?
4. Supozo se çfarë është dëmi i cili është krijuar ose do të ndodh në afat më të gjatë?

Lloje të korrupsionit

Ka tre lloje të korrupsionit. Për të ditur se për çfarë lloji bëhet fjalë, varet nga më tepër faktorë: nga ajo se kush në përgjithësi është i përfshirë në korrupsionin, a bëhet fjalë për funksionar të lartë ose nëpunës nga një vend më i ulët pune, çfarë është shuma e përfitimit material dhe jomaterijal, çfarë dëmi është bërë, kush është i dëmtuar, çfarë është ndikesa afatgjate, për çfarë forme të sjelljes korruptive bëhet fjalë e kështu me radhë.

K O R R U P S I O N I Z I

Korrupsion i “Zi” kriminal - përfshin më tepër aktivitete kriminele për të cilat gjykatat kompetente shqiptojnë vendime gjyqësore penale. Në këtë lloj të korrupsionit janë përfshirë edhe të gjithë faktorët të nivelit të lartë.

K O R R U P S I O N I

Korrupsion i “përhimët” kundërvajtëse - këto veprime korruptuese janë në vetë kufirin midis të drejtës dhe të padrejtës, ndërsa mund të jenë edhe të ndëshkuar. Këtu hynë: nepotizmi, kronizmi dhe patronazhi politik.

Nepotizmi paraqet sjellje korruptuese e cila ka të bëjë me punësimin dhe/ose avancimin e **kushërinjve** të afërt në administratën shtetërore dhe publike.

Kronizmi është sjellje e ngjashme korruptive si dhe nepotizmi i cili ka të bëjë me punësimin dhe/ose avancimin e **miqve** të afërt në administratën shtetërore dhe publike.

Patronazhi politik - paraqet sjellje korruptive e cila ka të bëjë me punësimin dhe/ose avancimin e anëtarëve partiak në pozita të larta në administratën shtetërore dhe publike. Klientelizmi dhe proteksioni janë të ndërlidhur me patronazhin dhe do të thonë mundësim të privilegjeve për klientët, favorizim të personave të caktuar për shkak të mbrojtjes ose meritës (më shpesh partiake/politike).

KORRUPSION I BARDHË

Korrupsion i “Bardhë”- i nënkupton (thënë kushtimisht) ato sjellje korruptive që në mjedise të caktuara, për shkak të kornizës kulturore dhe kuptimeve të vlerave, nuk konsiderohen si të amorale, duke pasur parasysh se nuk janë juridikisht të sanksionuara. Për shembull, dhurimi i sendeve me shumë ose vlerë të vogël në s, në sportel e ngj.).

1.2 EFEKTE/PASOJA NGA KORRUPSIONI

Korrupsioni prodhon pasoja negative në shoqërinë siç janë: padrejtësia, mos-stabiliteti politik, konkurrencë jo-fer dhe zvogëlim të besimit të qytetarëve në shtetin, si dhe në institucionet shtetërore dhe publike, organet dhe shërbimet.

Nëse politikanët që janë në pushtet janë të kyçur në veprime të shumta korruptuese, ajo sjell te besimi më i vogël të qytetarëve ndaj shtetit. Nëse në administratën shtetërore punësohen përmes nepotizmit, kronizmit dhe patronazhit politik, ajo ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në funksionimin e institucioneve.

Korrupsioni i rrezikon lirinë e tregut dhe sipërmarrësinë, zgjedhet e lira dhe fer, pavarësinë e gjyqësisë, kryerjen e funksioneve publike në interes shtetëror dhe në interes të qytetarëve, e jo në interes të individëve të caktuar ose të grupeve politike.

Korrupsioni ndikon negativisht në gëzimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut – të drejtave civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore. Korrupsioni ndikon në aftësinë e shtetit që ti mbrojnë të drejtat e njeriut dhe ti përmbush obligimet e veta, posaçërisht, për sigurimin e gjyqësisë funksionale dhe fer gjykimin, policinë, shëndetësinë, arsimin dhe shërbimet sociale e kështu me radhë.



AKTIVITET

Detyrë Për Diskutim

Diskuto dhe plotësoje skemën me katrorë të ri me shkaqe dhe pasoja, përkatësisht faktorë të cilët ndikojnë në paraqitjen e korrupsionit.

Pema e shkaqeve dhe të pasojave

- a) mospasje e ligjit;
- b) proteksione dhe patronazh partiak;
- v) mos-respektim i ligjeve;
- g) reforma të këqija në administratën;
- d) koncentrimi i pushtetit, pasurisë dhe statusit në individët;
- gj) regjim jodemokratik dhe autokrat;
- e) burokraci e ngadalshme;
- zh) ekzistimi i monopoleve;
- z) zhvillim i vogël industrial dhe infrastrukturor;
- x) shërbim i organizuar dobët dhe shërbim i paguar dobët publik;
- i) gjykata të cilat nuk dënojnë korrupsion të lartë;
- j) njerëz që vazhdimisht korruptojnë arsimtarë dhe mjekë;
- k) sistem ku pushteti, paratë dhe politika luajnë rol prijës;
- ll) mungesë e vullnetit për luftë kundër korrupsionit;
- l) mosparaqitje e korrupsionit.

PËRFITIM PERSONAL DHE PA- SURIM	KONCENTRIM I PUSHTETIT, PASURISË DHE TË STATUSIT	KEQPËRDORIM I DE- TYRËS ZYRTARE	EKZISTIMI I MONO- POLEVE
MUNGESË E LEGJIS- LATIVIT TË FORTË LIGJOR		MEKANIZMA TË DOBËT PËR PENGIM TË AKTIVITETEVE KORRUPTIVE	
PROCESE TRANZICIONALE		SHËRBIM PUBLIK I ORGANIZUAR DOBËT DHE I PAGUAR DOBËT PUBLIK;	
		SJELLJE JO-MORALE DHE JO-ETIKE	

PAS KËTIJ LEKSIONI DO TË DUHEJ TË MUNDESH:

FJALOR I **NOCIONEVE**

- ti kuptosh nocionet nga Fjalori
- të japësh shembuj për çdo nocion dhe ti sqarosh dallimet
- të sqarosh se çfarë lloje dhe tipe të korrupsionit ekzistojnë
- të kuptosh se cili është dëmi në baza të shumta

- korrupsion
- tipe të korrupsionit
- lloje të korrupsionit
- nepotizëm,
- kronizëm
- patronazh;
- ryshfet/mitë;
- konflikt të interesave;
- detyrë zyrtare;



TEMË PËR DILEMË

Shembull: Një pacienti ka nevojë që ti bëhet operacion urgjent. Doktorin e operon, ndërsa si kthim nga anëtarët e familjes së pacientit, si falënderim për operacionin e suksesshëm, merr pikturë të vlefshme artistike si dhuratë.

1. A ka sjellje korruptive? Nëse PO, sqaro ku.
2. Në çka përbëhet dilema?
3. A është etike?
4. A janë dhe cilat të drejta janë shkelur?
5. Kush ka realizuar përfitim në situatën e kështillë?



Propozim temë për hulumtim:

Gorani është nxënës i mençur, inteligjent dhe vazhdimisht mëson shkathtësi të reja. Ai është nxënës i shkëlqyer dhe aktiv në orët. Ai, gjithashtu, është futbollist i shkëlqyer me aftësi për organizim taktik të lojtarëve të tjerë gjatë vazhdës së lojës. Por, për fat të keq, arsimtari nuk e la-
vdëron. Ndërsa, në anën tjetër, Borisi, i cili është nxënës relativisht i dobët dhe luan shumë dobët në klubin futbollistik të shkollës, për befasi, është zgjedhur kapiten të klubit futbollistik, në vend që kapiteni të jetë Gorani.

Përse ajo është kështu?

1. Hulumto se si zgjedhet Kapiteni i klubit futbollistik shkollor në shkollën tuaj.
2. Bëjë disa intervista: me arsimtarin e kulturës fizike, me prindër të fëmijëve nga klubi futbollistik, si dhe me drejtorin e shkollës për tu njohur me të gjitha aspektet dhe palët e përfshira.
3. Shkruaj ese të shkurtër se si është bërë përzgjedhja dhe cilat janë kriteret për seleksionim për të qenë në ekipin ose në krye të ekipit futbollistik.
4. Sjell konkluzion nëse diku ekziston mundësi për sjellje korruptive, përkatësisht mundësi për keqpërdorim të detyrës zyrtare.



2. IDENTIFIKIMI I KORRUPSIONIT NË SFERA TË NDRYSHME TË JETËS SHOQËRO RE



Korrupsion politik

Korrupsioni politik paraqet keqpërdorim i autorizimeve ligjore nga funksionarët shtetëror për marrje të përfitimit kundër-ligjor pronësor, për pasurim personal ose grupor.

Korrupsioni politik përbëhet nga blerja e ndikesës politike dhe të votave gjatë zgjedhjeve. Politikanët e zgjedhur mund ti pranojnë pagesat jolegale nga biznesmenët për ti financuar partitë e tyre politike, fushatat zgjedhore ose vetë të pasurohen. Madje edhe financimi legal duhet të kontrollohet, sepse ata që i financojnë presin trajtim të veçantë në kërkesat e tyre për administratën ose privatizimin e kompanive, favorizimin gjatë tenderëve publik, kontratat në katër sye ngjashëm.

Çdo sistem i vërtetë politik patjetër duhet të gjejë mënyrë se si të zbatohen fushatat politike pa rryshfet dhe pa korrupsion.

Në funksione publike duhet të vendosen njerëz të ndershëm, të zvogëlohet fuqia e pushteteve, por edhe të vendosen kontrole më të mëdha mbi pushteteve, por edhe të vendosen kontrole më të mëdha mbi pushtetin nga kuvendi, opozita, Komisioni shtetëror për pengim të korrupsionit, gjyqësia, organizatat joqeveritare dhe institucionet e tjera kompetente.

Shembull:

Kompania e cila merret me import të kompjuterëve, gjatë zgjedhjeve parlamentare i jep një shumë të konsiderueshme të parave një partie politike e cila merr pjesë në zgjedhjet. Partia politike fiton në zgjedhjet. Pas disa muajve, shpallet thirrje për furnizim publik për blerje të kompjuterëve, prapëseprapë kompania e cila e ka financuar partinë politike merr tenderin.



AKTIVITET

Arsimtari do të japë shembull për diskutim.

1. Përcakto se për çfarë lloji të korrupsioni bëhet fjalë.
2. A bëhet sjellja korruptive me kërkesë, dhënie, pranim, përkrahje ose premtim?
3. Kush e kryen veprimin jo-moral?
4. Supozo se çfarë është dëmi që është shkaktuar?




Korrupsioni në gjyqësinë

Korrupsioni në gjyqësi, pavarësisht nga shkalla e përhapjes së tij gjithmonë zgjon brengosje më të madhe në opinionin. Gjykatësit e korruptuar, duke mos e respektuar parimin e paanshmërisë, nuk e respektojnë karakteristikën më të rëndësishme të sundimit të të drejtës – barazinë e njerëzve para ligjit.


Vendimi gjyqësor i anshëm të cilin e miraton gjykata, mund të krijohet me atë që gjykatësi në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe qëllimshëm do të sjell vendim gjyqësor në dobi të atij që ka shkelur ndonjë ligj të caktuar ose, ndërkaq, me ndikimin e vet gjatë gjykimit dhe miratimit të vendimit gjyqësor, do të bëjë të duket se ajo është vendim gjyqësor i drejtë. Ose, ndërkaq, mund ta shtyjë gjykimin deri në pafundësi, me qëllim që ta vjetërsojë veprën. Korrupsioni në gjyqësinë mund të paraqitet në formë të ryshfetit ose të marrjes me forcë. Shumë është me rëndësi që gjyqësia të mos jetë e korruptuar. Prandaj nevojitet zgjedhje e gjykatësve me përvojë, profesional dhe të ndershëm, nëpunës të aftë gjyqësor, prokurorë, avokatë, noterë, përmbaues dhe mediatorë, të cilët në mënyrë konsekuente do të përmbahen kodit të etikës në shërbimin e tyre.

Korrupsioni në policinë



Me nocionin korrupsion në policinë nënkuptohet çdo shkelje e veprimeve dhe procedurave standarde, keqpërdorimi i detyrës zyrtare ose tejkalim të autorizimeve policore për shkak të përfitimit të premtuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë, të ofruar, të kërkuar, të dhënë, të marrë, të pranuar ose të përfituar, për vete ose për ndonjë tjetër.

Faktorë më të shpeshtë që kontribuojnë për paraqitje të korrupsionit në policinë janë: me veprim kundër mos-profesionalizmit dhe organizimit të keq, punësimit të kuadrit jo-profesional, lënie anësh të kriterëve gjatë zgjedhjes dhe trajnimit të të punësuarve në Policinë.



Korrupsioni në arsimin

Punësimi në entet arsimore (shkolla, fakultete), dhënia e provimeve, dhënia e notave më të larta të pa merituar, favorizimi i nxënësve më të dobët para atyre më të mirë, marrje e vendeve në konviktet studentore dhe regjistrimi në fakultet janë fushat ku ekziston përhapje më e madhe e korrupsionit në këtë fushë.

Korrupsioni dhe sjellja korruptuese e rrezikojnë procesin arsimor dhe cilësinë e tij, e prishin integritetin e këtyre institucioneve, por edhe të pjesëmarrësve në të.



Korrupsioni në shëndetësinë

Në jetën e përditshme, nën nocionin korrupsion në shëndetësi zakonisht nënkuptohen sjelljet korruptive në lidhjen midis pacientit dhe mjekut si dhe dhënie e mitës në para ose vlera të tjera materiale ose jo-materiale për dhënie të shërbimeve të caktuara mjekësore ose për marrje të tyre në kohë.

Përveç kësaj forme, ekzistojnë edhe forma në mënyrë më të konsiderueshme më të ndërlikura të korrupsionit në shëndetësinë. Ashtu për shembull, një formë është kur kompanitë për barna me ryshfet, ose në çfarë do mënyrë tjetër jo-etike, sigurojnë testim ose përdorim të barnave të tyre. Mandej vijon korrupsioni gjatë lidhjes së kontratave blerje dhe servil të pajisjes medicinale, barnave dhe servil të pajisjes medicinale, barna dhe material shpenzuese në spitalet. Me siguro formë më e rëndësishme është punësimi dhe avancimi i njerëzve të cilët punojnë në spitalet, e bazuar në nepotizëm.



Korrupsioni ekonomik

Korrupsioni më shpesh është i gjeneruar nga shkaqe ekonomike, sepse me paratë, pothuajse mund "të blihet" çdo gjë dhe përmes tyre realizohen dhe kënaqen interesa të ndryshme personale dhe të tjera.

Korrupsioni ekonomik më së shpeshti vjen në shprehje në **procedurat për furnizime publike** gjatë keqpërdorimit ose tejkalimit të autorizimeve.

Furnizim publik është blerje e materialeve, mjeteve dhe/ose shërbimeve nga organet shtetërore, shkollat, organizatat, institucionet ose persona të tjerë juridik.

Furnizimi bëhet sipas kriterëve të caktuar, ndërsa ato janë çmimi më i volitshëm. Mund të bëhen furnizime publike me edhe pa thirrje për të marrë pjesë të gjitha palët e interesuara të cilat mund ti përmbushin kushtet. Më me rëndësi është që të gjithëve tu mundësohet qasje e njëjtë. Shembull për keqpërdorim të mundshëm dhe korrupsion ka kur merren vesh "sy më sy" për çmimin, cilësinë, dhënien e furnizimeve ose shërbimeve, si dhe kushtet e tjera për anë të volitshme dhe cilësi. Marrëveshja është midis atij që e shpall thirrjen dhe kompanisë e cila "duhet" ta fitojë tenderin ose furnizimin. Në atë rast pamundësohet e drejta e më tepër kompanive të konkurrenjës.

dhe në atë mënyrë nuk sigurohet fer garë për të fituar ai që do të ofrojë çmim më të mirë dhe cilësi më të mirë të furnizimit. Më shpesh në raste të tilla përfitim personal marrin të dy palët, e më së shumti humbin ata për të cilët është dedikuar furnizimi. Ajo do të thotë se nëse duhet të sigurohet ushqim për nxënësit në shkollën ka mundësi për korrupsion në procedurën për furnizim publik nëse nuk sigurohet qasje e njëjtë për kompanitë dhe nëse bëhet rregullimi i kritereve që do ti përmbush vetëm një kompani.

Shembull:

Shkolla fillore XX tanimë 7 vjet me radhë ka lidhur marrëveshje për furnizim me ushqim me të njëjtën kompani për një çmim shumë të lartë. Në tenderin janë paraqitur edhe kompani të tjera, mirëpo të njëjtat vazhdimisht kanë qenë të diskualifikuara.

Furnizimet publike janë burimi më i madh i korrupsionit. Shpenzohen mjete nga buxheti, para nga fondi i komunës ose shkollës për furnizime publike të materialeve të ndryshme.

PAS KËTIJ LEKSIONI DO TË DUHEJ TË MUNDESH:

- ti kuptosh nocionet nga Fjalori
- të kapësh shembull për çdo nocion
- ti sqarosh dallimet
- të sqarosh se çfarë lloje të korrupsionit ekzistojnë
- të kuptosh se çfarë është dëmi në shumicën e fushave

FJALOR I NOCIONEVE

- korrupsion politik,
- korrupsion në gjyqësi, polici, arsim, shëndetësi, korrupsion ekonomik, korrupsion i imët;
- funksione publike;
- furnizim publik;
- procedurë e furnizimit publik



TEMË PËR DILEMË

Shembull: Ministria e shëndetësisë vendos të blejë aparate të reja për rëntgen në spitalet shtetërore në pesëmbëdhjetë qytete në vend. Njëra nga kompanitë e interesuara i qaset ministrit dhe i ofron një përqindje të caktuar nga kontrata, nëse ata e fitojnë tenderin. Ministri pajtohet dhe e kontraktin vazhden e procedurës me nëpunësin i cili e zbaton furnizimin publik. Nëpunësi është i shpërblyer me avancim në karrierën për ta mbajtur gojën të mbyllur. Ndërkaq kompania e cila e fiton tenderin është e regjistruar në Ishujt Virgjine të Britanisë, ndërsa pronari i saj anonim në fakt është kryetari i një komune dhe në të njëjtën kohë është edhe mik i mirë i ministrit.

1. A ka sjellje korruptive? Nëse PO, sqaro ku.
2. Në çka përbëhet dilema?
3. A është etike?
4. A janë dhe cilat të drejta janë shkelura?
5. Kush ka realizuar përfitim në situatën e tillë?
6. A do ta kishit pranuar ofertën e tillë?

INFORMACIONE SHITESË



Korrupsioni i imët

Qytetarët shpesh herë e kanë të njohur të ashtuquajturin “korrupsion të imët” nga jeta e përditshme, por për atë më shpesh konsiderojnë se nuk është i rrezikshëm për shoqërinë dhe se madje është dukuri e pranueshme në shoqëri. Shumë njerëz udhëhiqen nga mendimi se rryshfeti i imët mund t’ju ndihmojë në zgjidhjen e problemeve të mëdha.

Dhënia e rryshfetit nëpunësve publik me qëllim të përshpejtimin të ndonjë procesi (lëshimi i vërtetimit, dokument publik, mënjanim ose shmangie e pagesës së dënimit, caktimi i kontrollit ose të operacionit e kështu me radhë) janë situata tipike të cilat e përfaqësojnë këtë korrupsion “të imët”.

Njerëzit më së shpeshti nuk konsiderojnë se është korrupsion nëse qerasin dikë, nëse i japin dhuratë ose kryejnë ndonjë shërbim. Prandaj, dhënia e mitës, pagesat joformale, dhuratat i konsiderojnë si dukuri normale. Kjo sjell në situatë kur qytetarët mësohen në dukurinë e korrupsionit përkatësisht ajo bëhet dukuri normale në shoqërinë. Ajo paraqet kërcënim dhe hyrje në nivel më të lartë të korrupsionit dhe për qytetarët si dhënës të mitës edhe për nëpunësit, të cilët të mësuar në dhurata të imëta, i shtojnë apetitet e veta dhe kërkojnë çmim më të lartë për ta bërë detyrën e vet të punës, të cilën edhe ashtu janë të detyruar ta kryejnë sepse për atë marrin rrogë.



Propozim temë për hulumtim:

Shkolla fillore shpall thirrje për furnizim publik për grumbullimin e ofertave për transport dhe vendosje të nxënësve në ekskursion dyditor. Në thirrjen paraqiten 5 agjenci turistike dhe zgjedhet oferta që kushton më shumë e cila nuk është sipas Rregullores për ekskursione pranë Ministrisë së arsimit.

Përse është ajo ashtu?

1. Hulumto se çfarë është procedura për furnizim publik në shkollën tuaj dhe cili ka qenë furnizimi i fundit.
2. Bëjë disa intervista me drejtorin e shkollës, arsimtarin dhe prindin a janë të njoftuar me përmbajtjen e furnizimit publik dhe nëse kanë marrë pjesë në zgjedhjen dhe seleksionimin e agjencisë e cila do ta organizojë udhëtimin.
3. Merr vesh kush ka marrë pjesë në përzgjedhjen e agjencisë.
4. Konstatohet cila agjenci e ka marrë tenderin në furnizimin e fundit dhe nëse e njëjta agjenci vazhdimisht e merr tenderin.
5. Shkruaj ese të shkurtër për atë se si ka përfunduar furnizimi publik.

3. BALLAFAQIMI DHE PENGIMI I KORRUPSIONIT



A MUND TË MBROHEMI NGA KORRUPSIONI?

Korrupsioni është një nga sfidat më të mëdha të kohës sonë. Korrupsioni është dukuri bren-gosëse për tërë shoqërinë dhe duhet të kundërshtojmë në mënyra të ndryshme për ta penguar paraqitjen e saj.

Për tu zvogëluar pasojat negative të cilat krijohen nga korrupsion, nevojitet që në shtetin të vendoset politikë e fortë për luftë kundër korrupsionit, për shkak të mbrojtjes së qytetarëve dhe të shtetit, e posaçërisht për shkak të vendosjes dhe respektimit të sundimit të të drejtës.

Në kuadër të mbrojtjes dhe pengimit të korrupsionit, nevojitet respektimi i 5 parimeve vijuese: parimi i ligjshmërisë, parimi i integritetit, parimi i barazisë, parimi i transparencës dhe parimi i mbrojtjes dhe i përgjegjësisë.



Parimi i ligjshmërisë do të thotë respektim të normave juridike të përshkruara në Kushtetutën dhe ligjet e shtetit. Çdokush është i obliguar që në kryerjen e funksionit, detyrës zyrtare dhe pozitës të veprjë në pajtim me Kushtetutën dhe me ligjet në shtetin. Askush nuk guxon ta shfrytëzon funksionin, detyrën zyrtare ose pozitën për kryerje të ndonjë veprimi që sipas ligjit nuk guxon ta kryejë. Askush nuk guxon që kryerjen e veprimit ligjor ta shfrytëzojë për interesin e vet personal ose për interes të personit tjetër.

Parimi i integritetit do të thotë gatishmëri e individit që të dallojë dhe në mënyrë vendimtare të kundërshtojë në ndonjë situatë joligjore, amorale ose të pandershme. Nën nocionin "integritet" nënkuptohet kryerje e ligjshme, e pavarur, etike, e përgjegjshme dhe transparente e punëve me të cilat personat zyrtar e ruajnë shëmbëlltyrën e vet dhe shëmbëlltyrën e institucionit në të cilin janë të punësuar.

Shembull:

Mjeku, i cili në të njëjtën kohë është edhe kryeshef i repartit të kirurgjisë, në të gjitha mbledhjet me personelin mjekësor në repartin e tij (mjekë, infermiere, teknikë, personel ndihmës mjekësor), vazhdimisht ju vë në pah se assesi nuk duhet të pranojnë dhurata nga pacientët dhe anëtarët e familjeve të tyre dhe se shërbimet të cilat ua japin pacientëve janë në kuadër të fushëveprimit të punës së tyre për të cilën janë të paguar nga shteti. Nga ana tjetër, i njëjti ky kryeshef, pas operacionit të kryer i pranon në zyrën e tij anëtarët e familjeve të pacientëve për tu shpjeguar ndërhyrjet kirurgjikale që janë bërë mbi pacientin dhe atje i pranon dhuratat e tyre. Ajo do të thotë se ky mjek nuk posedon integritet personal dhe profesional.

Çdokush është i obliguar që në zbatimin e funksionet të veprjë me vetëdije, përgjegjësi, në mënyrë profesionale, të ndershme, të ndershme, efikase dhe të paanshme. Duke e pasur parasysh rëndësinë e integritetit të personalitetit, aplikohet testi i integritetit si mekanizëm për sigurim të etikës dhe të moralit të personit, dhe me atë do të kontribuohet ndaj pengimit të korrupsionit dhe paraqitjes së konfliktit të interesave.

Personi zyrtar në kryerjen e funksionit të vet është i obliguar që të ketë kujdes për konflikt eventual të interesave dhe gjatë zbatimit të obligimeve dhe të detyrave zyrtare nuk guxon të udhëhiqet nga interesat personale, familjare, fetare, partiake dhe etnike, e as nga presionet dhe premtimet e eprorit ose të ndonjë personi tjetër.




AKTIVITET

DETYRË:

Diskuto me nxënësin afër teje për fotografitë më poshtë.

1. A ka ndonjë dallim mes fotografive?
2. Çfarë është shfaqur në fotografinë e parë dhe çfarë në fotografinë e dytë?
3. Çka mendon – çfarë ndodh dhe çfarë kërkohet si kthim? Jep një shembull tëndin..



Fotografia 1




Fotografia 2

Parimi i barazisë ka të bëjë me qasje të njëjtë, procedim të njëjtë, krijim të lirë dhe barazi gjatë paraqitjes së korrupsionit. Çdokush ka të drejtë për qasje të njëjtë ndaj kryerjes së punëve me interes publik dhe të drejtë për procedim të njëjtë nga bartësit e pushtetit dhe personat të cilët kryejnë autorizime publike dhe detyra zyrtare. Çdokush ka të drejtë për paraqitje të lirë dhe për garë të lirë, pa droje se mund të jetë viktimë e sjelljes diskriminuese. Çdokush ka të drejtë që të pengojë ose paraqesë korrupsion ose kryerje, përkatësisht mos-kryerje të veprimit që paraqet shfrytëzim të funksionit, autorizimeve publike, detyrës zyrtare ose të pozitës për ti bërë dëm tjetrit, duke mos pësuar çfarë do qoftë pasoja.

Parimi i transparencës - Ushtrimi i pushtetit, funksionit, autorizimeve publike, detyrës zyrtare dhe të punëve me interes publik janë publike dhe u nënshtrohen kontrollit publik të qytetarëve. Ajo do të thotë se opinioni, përkatësisht qytetarët – në mënyrë individuale ose të organizuar në grup janë të interesuar dhe kanë të drejtë të dinë për mënyrën dhe kushtet në të cilat praktikohet pushteti. Organet shtetërore për punën e vet janë të detyruar ti informojnë qytetarët, ndërsa qytetarët, ndërkaq, kanë të drejtë që të ndërmarrin aksion (paraqitje) kundër ata nëpunës shtetëror sjellja e të cilëve nuk është e rregullt dhe është e paligjshme.

Parimi i mbrojtjes dhe përgjegjësi - Ky parim nënkupton se çdokush, nëse ka informacione, ka të drejtë të paraqesë dyshim ose njohuri për korrupsion dhe të jetë i mbrojtur në pajtim me ligjin. Çdokush që është i dëmtuar me veprë korruptive ka të drejtë të kërkojë zhdëmtim të dëmit.



1. Përcakto për cilin parim bëhet fjalë.
2. Përcaktoje tipin dhe llojin e korrupsionit në shembullin.
3. A ke hasur shembull i tillë në rrethimin tënd.

TEMË PËR DILEMË

Shembull: Petar duhet ti nënshtrohet provimit për patent shoferi, por edhe vetë e din se nuk ndjehet shumë i sigurt dhe nuk i njeh mirë rregullat e komunikacionit. Gjatë dhënies së provimit Petar bën një numër të madh të gabimeve dhe disa herë kthen duke mos i lëshuar dritat e kthimit. - Por, edhe përkundër kësaj, anëtarët e Komisionit për dhënie të provimit në ditën e provimit praktik për vozitje nëpër qytet e lavdërojnë dhe i tregojnë se e ka dhënë provimin. Petar është i habitur, por edhe i lumtur. Në mbrëmje kupton se e ka kaluar provimin sepse prindi i tij i ka paguar me pare shumicën e anëtarëve të Komisionit.


Përcakto se për cilin parim bëhet fjalë në shembullin.

1. A është etike sjellja e prindit?
2. A është etike sjellja e anëtarëve të Komisionit? A kanë qenë të blerë të gjithë anëtarët?
3. Në çfarë përbëhet dilema?
4. Përse është i rëndësishëm integriteti i anëtarëve të Komisionit?
5. A duhet Petar të paraqesë? A është mirë të paraqitet?
6. Çfarë është dëmi potencial?

Çdo qytetar mund ta shfrytëzojë ndonjërin nga mjetet ose procedurat të cilat janë të theksuara në tekstin e mëtejshëm për të paraqitur sjellje të caktuar korruptive te institucionet kompetente.



3.1 MJETE PËR LUFTË KUNDËR KORRUPSIONIT




Lufta kundër korrupsionit nuk është proces i thjeshtë, por nënkupton angazhim të tërë shoqërisë dhe ngritje të iniciativave në të gjitha nivelet. Çdo qytetar ka obligim ligjor dhe moral të luftojë kundër korrupsionit. Kjo do të thotë jo vetëm të njohësh korrupsionin dhe përmbajtje nga veprime korruptive, por edhe paraqitje raste të korrupsioneve.

Mjetet për luftë kundër korrupsionit janë masa, aktivitete, institucione dhe organe në shtetin përmes të cilit dallohen dhe zbulohen aktivitet korruptuese, gjenden, kapen dhe në mënyrë përkatëse ndëshkojnë persona të korruptuar.

Çdo qytetar mund ta shfrytëzojë ndonjërin nga mjetet ose procedurat të cilat janë të theksuar në tekstin e mëtejshëm për të paraqitur sjellje të caktuar korruptive te institucionet kompetente.

Kallëzim penal



Lufta kundër korrupsionit fillon me çdonjërin nga ne. Çdo qytetar duhet ta kundërshtojë korrupsionin me atë që nuk do të marrë ose të japë ryshfet, do ti respektojë dispozitat ligjore dhe do ti nxis të tjerët që ta bëjnë të njëjtën. Nëse dyshojmë ose vërejmë korrupsion në ndonjë vend, atëherë, rastin e tillë duhet ta paraqesim. Vegla fillestare dhe më e fuqishme për ballafaqim me sjelljen ekzistuese korruptive është parashtrimi i kallëzimit penal. Ai i parashtrohet Prokurorisë Themelore Publike (PTHP).


Qytetari mund ta paraqesë rastin me korrupsion edhe në polici – në mënyrë gojore dhe me shkrim, përmes paraqitjes së drejtpërdrejtë në stacionin më të afërt policor ose përmes telefonit. Me këtë rast, policia është e obliguar ta lajmërojë prokurorin kompetent themelor publik për rastin.



Mbrojtje si denoncues

Denoncuesit e korrupsionit mund të gëzojnë mbrojtje më të madhe pas paraqitjes së sjelljes korruptive. Denoncues mund të jetë person i cili paraqet veprime joligjore në kuadër të marrëdhënies së vet punuese. Ai mund të jetë i punësuar, praktikant, bashkëpunëtor i jashtëm e ngjashëm.

Mbrojtja e cila fitohet ka të bëjë me atë se denoncuesi nuk mund të largohet nga puna, nuk mund të shkojë prapa në hierarkinë të punëdhënësi, nuk mund ti zvogëlohet rroga e ngjashëm. Domethënë, denoncuesi dhe personi i afërt me të janë të mbrojtur nga dëmi eventual i cili mund të shkaktohet pikërisht për shkak të paraqitjes. Denoncuesi e bën paraqitjen me qëllim të mirë, gjithashtu nuk guxon ta keqpërdor mbrojtjen.




Komisioni shtetëror për pengim të korrupsionit

Komisioni shtetëror për pengim të korrupsionit (KSHPK) është i themeluar si trup i pavarur qëllimi i të cilit është zbatimi i masave dhe të aktiviteteve për pengim të korrupsionit. Njëri nga kompetencat e saj është të procedojë për parashtrës të qytetarëve të cilët paraqesin korrupsion tek ajo.

Procedura ngrihet me paraqitjen e fletëparaqitjes. Mandej Komisioni e shqyrton atë fletë paraqitje, e mandej mund të vendos ta hetojë rastin. Komisioni mandej grumbullon informacione për të mund të sjellë vendim. Nëse konstaton se ekziston dyshim për ekzistim të korrupsionit, ajo mund të kërkojë nga prokurori publik të ngre procedurë për përcaktimin e përgjegjësisë penale.

Nëse bëhet fjalë për rast të konfliktit të interesave, Komisioni ka të drejtë edhe vetë të shqiptojë masa të caktuara. Nëse konstatohet konflikt i interesave, ajo fillimisht do të kërkojë nga funksionari që të heq dorë nga njëri funksion, mandej do të shqiptojë edhe vërejtje publike, ndërsa nëse ai/ajo edhe më tej nuk vepron në sajë të kërkesave të komisionit, ajo do ta kërkojë edhe shkarkimin e tij/të saj.

Avokati i popullit



Procedura para Avokatit të popullit nisët me parashtrësë, ngjashëm edhe si para KSHPK. Ajo parashtrëhet me shkrim ose gojarisht. Parashtrësja nuk mund të jetë anonime. Nevojitet që të përmbajë edhe rrethanat për rastin, organizimin për të cilën ka të bëjë, si dhe dëshmi të cilat i mbështesin pohimet e shprehura në të. Parashtrësja mund të paraqitet edhe në emër të personit tjetër, por atëherë Avokatit të popullit i nevojitet pëlqim i nevojitet pëlqim nga i dëmtuari për të procedojë në sajë të asaj.

Nëse Avokati i popullit konstaton se ekziston për korrupsion, ai mund ti parashtrojë kërkesë për ndjekje penale prokurorit publik. Mandej prokurori publik është ai që në bazë të dëshmive të cilat i ka në dispozicion dhe sipas bindjes së vet personale vendos nëse do të zbatojë hetim shtesë ose të do ngre akuzë.


Organizata joqeveritare



Organizatata joqeveritare të cilat punojnë në fushën e antikorruptsionit, ju qëndrojnë në dispozicion qytetarëve si mjet për ballafaqim me korrupsionin. Shumë prej tyre ofrojnë ndihmë juridike falas, sigurojnë informacione të caktuara, ngritje të vëmendjes mediatike, e në raste më të rralla madje edhe parashtrojnë kallëzim penal në lidhje me rastin.

Ato shumë shpesh bëjnë analiza, shkruajnë raporte dhe i përcjellin rastet me sjellje korruptive që udhëhiqen në gjykatat, ndërsa të gjitha këto aktivitete i publikojnë dhe në faqet e tyre të internetit.

Medie



Mediet (televizionet, radio stacionet, gazetatat, internet portalet e të tj.) gjithmonë janë të interesuar për storie interesante kriminele, kështu që rastet me aktivitete korruptive mund ti kenë për publikim. Qytetari i cili viktimë e korrupsionit mund t'ia rrëfejë rastin gazetarit, i cili, nëse interesohet, do të bëjë kontribut / storie gazetareske dhe do të publikohet në mediet.

Mediet, gjithkund ku janë të lira, e dënojnë korrupsionin në politikën dhe në biznesin. Në atë mënyrë, qytetari i bën presion publik atij që është i korruptuar.

Kodeks për sjellje etike



Kodet etike të sjelljes janë dokumente të dobishme të cilat patjetër duhet të respektohen dhe të përkrahen nga të punësuarit në institucionin. Në to, me stil të shkurtër, të qartë dhe të kuptueshëm janë të përshkruara rregullat etike dhe vlerat të cilat patjetër duhet të respektohen gjatë punës, me qëllim që të punësuarit të ndërtohen në njerëz etik, përkatësisht njerëz me vlera dhe cilësi të larta morale.

Të punësuarit gjithmonë duhet të jenë të përgatitur që ta zgjedhin të mirën si mënyrë dhe stil të vetin të të jetuarit, të sjelljes dhe të komunikimit. Me atë rast, patjetër duhet të zbatohen trajnime për të gjithë të punësuarit përmes të cilave më mirë do të njihen me përmbajtjet e kodekseve etike.

PAS KËTIJ LEKSIONI DO TË DUHET TË MUNDESH:

FJALOR I NOCIONEVE

- ti dish nocionet nga fjalori
- ti sqarosh parimet themelore për mbrojtje nga korrupsioni
- të japësh shembull për çdo nocion
- të dish cilat janë mjetet për ballafaqim me korrupsionin

- ligjshmëri
- integritet,
- barazi,
- transparencë, interes publik,
- mbrojtje dhe përgjegjësi,
- denoncues,
- fletëparaqitje



TEMË PËR DILEMË

Shembull: Teatri i një qyteze shpall konkurs për punësim për punësim të aktorit/aktore. Në shpalljen paraqiten pesë kandidatë, midis të cilave edhe e bija e drejtorit të teatrit. Ajo edhe një kandidat tjetër janë njëloj të kualifikuar për vendin e punës. Drejtori prapëseprapë e punëson vajzën e vet.

1. A ka sjellje korruptive? Nëse PO, sqaro ku?
2. Në çka përbëhet dilema?
3. Për cilët parime bëhet fjalë?
4. Të drejtat e kujt janë të shkelura?
5. Kush do të kishte realizuar përfitim në një situatë të këtillë?
6. Çfarë do të kishit bërë ju në vendin e juaj?



Propozim temë për hulumtim:

Sipas hulumtimeve të fundit të Transparency International shteti më i korruptuar në botë është Somalia, ndërsa më jo i korruptuar është Danimarka.

Përse është kjo ashtu?

1. Hulumto se çfarë mjete për pengim të korrupsionit ekzistojnë në Danimarkë.
2. Bëjë krahasim me ata që ekzistojnë në Somali ose ndonjë shtet tjetër.
3. Kupto se cilat janë mekanizmat për paraqitje dhe nëse përdoren shpesh nga qytetarët.
4. Shkruaj ese të shkurtër për mendimin tënd në raport me rezultatet e fituara.

Nëse dëshiron më tepër informacione vizito ueb – lokacionet vijuese
www.antikorupcija.mk
www.prijavikorupcija.mk
www.transparency.org
www.transparentnost-mk.org.mk
www.transparency-watch.org

LITERATURË E PËRDORUR:

- Anti Korrupsion, Internacional Maqedoni, "Doracak i vogël për ta dalluar dhe për ta ballafaquar korrupsionin", Shkup, 2015
- Vllado Kambovski, "Korrupsioni – e keqja më e madhe shoqërore dhe kërcënim për shtetin juridik", koment i Ligjit për pengim të korrupsionit dhe të Ligjit për pengim të larjes së parave, Vlabor, SHPK, Shkup, 2002
- Emina Nuredinovska, Marija Sazdevski, Borjan Gjuzellov, "Raport për vlerësim të korrupsionit në Maqedoni", Qendra maqedonase për bashkëpunim ndërkombëtar, Shkup, 2014
- Ligji për pengim të korrupsionit dhe konfliktit të interesit, "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", numri 12, viti LXXV, 19.01.2019
- Jasna Orovcane Arangjeloviq, Martina Martinova "Doracak për pengim të korrupsionit në vetëqeverisjen lokale", Fondacioni Konrad Adenauer në R. E Maqedonisë dhe Shoqata maqedonase të juristëve të ri
- Zyra e Kombeve të Bashkuara për drogë dhe krim, Korrupsioni në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë: dhënie e ryshfetit e provuar nga popullata, Vienë, 2011
- Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit, e miratuar nga Asambleja e përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 31 tetor të vitit 2003 me Rezolutën nr. APEC/58/4
- Miodrag Llaboviq, "Pushteti korrupton", De Gama, Shkup, 2006
- Miodrag Llaboviq, matjan Nikollovski, "Krimi i organizuar dhe korrupsioni, dimensione më të reja teorike, pasoja praktike dhe metodika e hulumtimit, Fakulteti për siguri, Shkup, 2010
- Mihajllo Manevski, "Korrupsioni në Republikën e Maqedonisë, masa parandaluese dhe ndëshkuese për pengim", Shkup 2005
- Misioni i OSBE në Shkup, "Praktika më të mira në luftë kundër korrupsionit", 2002

DORACAK PËR LUFTË KUNDËR KORRUPSIONIT

Botues

Instituti për demokraci "Societas Civilis" – Shkup
contact@idsccs.org.mk
www.idsccs.org.mk

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

343.352(035)

PECOVA Ilieska, Liljana

Doracak për punë në orë i dedikuar për nxënësit e arsimit të mesëm në temën "Luftë kundër korrupsionit" / [authorë Liljana Pecova Ilieska, Kire Babanoski, Ana Janevska Deleva]. - Shkup : Instituti për demokraci Societas Civilis, 2020. - 39 стр. : илустр. ; 25 см

Публикацијата е во рамки на проектот: "Edukimi anti-korruptues për nxënës në shkollat e mesme". - Библиографија: стр. 38

ISBN 978-608-4775-63-8

1. Babanoski, Kire [автор] 2. Janevska Deleva, Ana [автор]

а) Корупција - Спречување - Прирачници

COBISS.MK-ID 112390666

Doracaku është i përpiluar në kuadër të projektit "Edukimi anti-korruptues për nxënës në shkollat e mesme" të financuar me ndihmë të Ambasada e Mbretërisë së Hollandës në Shkup, i implementuar nga Instituti për demokraci "Societas Civilis", Shkup në bashkëpunim me Komisionin Shtetëror për pengim të korrupsionit, në periudhën nga 1 janari i vitit 2019 – 31 dhjetor të vitit 2020.

Informacione për IDSCS

IDSCS është tink tenk organizatë e cila e hulumton zhvillimin e menaxhimit, sundimit të të drejtës dhe integritet evropiane të Maqedonisë Veriore. IDSCS ka mision ta ndihmojë përfshirjen qytetare në miratimin e vendimeve dhe ta fuqizojë kulturën participative politike. Përmes fuqizimit e vlerave liridashëse, IDSCS kontribuon për bashkëjetesë midis dallimeve.

Kontakt të dhëna për IDSCS

Adresa: rr. "Miroslav Kërlezha" nr. 52/1 /2, 1000 Shkup. Nr. telefoni: +389 2 3094 760 ,
posta elektronike: contact@idscs.org.mk

Informacione për KSHPK

Komisioni shtetëror për pengim të korrupsionit (KSHPK) është i mëvetësishëm dhe i pa varur në kryerje të punëve të përcaktuara me Ligjin për pengim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave dhe ka cilësi të personit juridik. Komisioni shtetëror për pengim të korrupsionit aplikon dhe inicion aplikim të ligjeve, nxit fuqizim normativ dhe institucional, krijon politika dhe masa anti-korruptimit, ndërmerr aktivitete në drejtim të fuqizimit të integritetit personal dhe institucional, përmes edukimit dhe fuqizimit të vetëdijes për korrupsionit dhe konfliktit të interesave, promovon bashkëpunim ndër institucional dhe ndërkombëtar dhe zhvillon kulturë juridike, ndërsa mision i i tij është të vendos sistem efikas për parandalim dhe represion të korrupsionit dhe konfliktit të interesave.

Kontakt informacione për KSHPK:

rr. "Dame Gruev" nr. 1, 1000 Shkup, nr. i telefonit : +389 2 3215 377, posta elektronike contact@dksk.org.mk, ueb faqe www.dksk.mk.

Informacione për projektin

Instituti për demokraci "Societas Civilis" – Shkup në periudhën nga janari i vitit 2019 deri në dhjetor të vitit 2020 do ta implementojë projektin "Edukimi për anti-korrupsionin në shkollat e mesme" të financuar nga Ambasada e Mbretërisë së Hollandës.

Projekti do ta ngrejë vetëdijen e të rinjve për korrupsion, format e korrupsionit dhe mjetet për luftë kundër korrupsionit. Bashkë me IDSCS, Komisioni shtetëror për pengim të korrupsionit është partner për bashkë-implementim në përgatitjen e planit të aksioneve, materialeve dhe përgfaqësim për ndryshim të politikës dhe të implementimit. Projekti implementohet me përkrahje të Ministrisë së arsimit dhe të shkencës dhe Byronë për zhvillim të arsimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Qëllimi i projektit është ngritje e vetëdijes tek të rinjtë për korrupsionin, fuqizimin e diturive të tyre për korrupsion, forma të korrupsionit dhe mjete për luftë kundër korrupsionit, si dhe fuqizim i diturisë së tyre për rëndësinë e ndërtimit të integritetit personal.

Link

Ky publikacion në mënyrë elektronike është i qashtë në:
<https://idscs.org.mk/mk/portfolio/doracak-per-pune-ne-ore/>

